



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

**Nr. 1 datë 5.1.2022**

**PËR**

**MIRATIMIN E KËRKESËS SË BASHKISË SHKODËR, SË BASHKU ME DOKUMENTACIONIN TEKNIKO LIGJOR PËR AKORDIMIN E NDIHMËS FINANCIARE PËR FAMILJEN E Z. ARMANDO ELEZ LEKAJ , DRITAN ELEZ LEKAJ , ELEZ ZENEL LEKAJ DHE ZNJ. SHEUKIJE FAIK BARDHI , BANESAT E TË CILËVE U JANË DËMTUAR NGA ZJARRI.**

Këshilli i Bashkiak Shkoder, në mbledhjen e datës 5.1.2021, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“ i ndryshuar; ligjin nr. 45/2019, “Për Mbrojtjen Civile”, VKM-së nr. 329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore“, VKM-së nr. 414 datë 08.07.2021 “ Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave nr. 263 datë 24.05.2013 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve ndërtimore të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, VKB Nr 63 datë 28.12.2020 “ *Për miratimin e buxhetit të vitit 2021 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2021-2023 të Bashkisë së Shkodrës*” i ndryshuar , Shkresa me Nr. 3950 Prot., datë 21.06.2017 e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe në Relacionin e përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër,

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Shkodër për ndihmën e menjëhershme financiare familjes së **z. Armando Zenel Lekaj** (1 anëtarë familje), në vlerën prej 20 000 (njetzet mijë ) lekë, për dëmtimin e banesës së tij nga zjarri.
2. Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Shkodër, për familjen e **z. Armando Zenel Lekaj** në vlerën e dëmit nga ana ndërtimore 637 786 (gjashtëqind e tridhjetë e shtatemije e shtateqind e tetëdhjetë e gjashtë ) lekë, dhe në orendi, mobilje dhe elektroshtëpiake në vlerën prej 114 600 (njetqind e katermbëdhjetë mije e gjashtëqind) lekë, sipas preventivave të Komisionit të vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Shkodër, për familjen e **z. Armando Zenel Lekaj** .
3. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Shkodër për ndihmën e menjëhershme financiare familjes së **z. Dritan Zenel Lekaj** (1 anëtarë familje), në vlerën prej 20 000 (njetzet mijë ) lekë, për dëmtimin e banesës së tij nga zjarri.
4. Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Shkodër, për familjen e **z. Dritan Zenel Lekaj** në vlerën e dëmit nga ana ndërtimore 637 786 (gjashtëqind e tridhjetë e shtatemije e shtateqind e tetëdhjetë e gjashtë ) lekë, dhe në orendi, mobilje dhe elektroshtëpiake në vlerën prej 123 400 (njetqind e njetzet e tremije e katerqind ) lekë, sipas preventivave të Komisionit të vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Shkodër, për familjen e **z. Dritan Zenel Lekaj** .
5. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Shkodër për ndihmën e menjëhershme financiare familjes së **z. Elez Zenel Lekaj** (2 anëtarë familje), në vlerën prej 40 000 (dyzet mijë ) lekë, për dëmtimin e banesës së tij nga zjarri.
6. Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Shkodër, për familjen e **z. Elez Zenel Lekaj** në vlerën e dëmit nga ana ndërtimore 637 786 (gjashtëqind e tridhjetë e shtatemije e shtateqind e tetëdhjetë e gjashtë ) lekë, dhe në orendi, mobilje dhe elektroshtëpiake në vlerën prej 229 200 (dyqind e njetzet e nentemije e dyqind ) lekë, sipas preventivave të Komisionit të vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Shkodër, për familjen e **z. Elez Zenel Lekaj** .
7. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Shkodër për ndihmën e menjëhershme financiare familjes së **znj. Sheukije Faik Bardhi** (1 anëtarë familje), në vlerën prej 20 000 (njetzet mijë ) lekë, për dëmtimin e banesës së tij nga zjarri.
8. Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Shkodër, për familjen e **znj. Sheukije Faik Bardhi** në vlerën e dëmit nga ana ndërtimore 637 786 (gjashtëqind e tridhjetë e shtatemije e shtateqind e tetëdhjetë e gjashtë ) lekë, dhe në orendi, mobilje dhe elektroshtëpiake në vlerën prej 192 600 (njetqind e nentëdhjetë e dymije e gjashtëqind ) lekë, sipas preventivave të Komisionit të vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Shkodër, për familjen e **znj. Sheukije Faik Bardhi** .

9. Burimi i financimit të jetë fondi i emergjencave civile parashikuar në programin P03280 “ Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile” në buxhetin e Bashkisë Shkodër për vitin 2020 të miratuar me VKB nr 63 . datë 28.12.2020, në programin P03280, O1 A2 “ Përballimi i ndihmave të menjëhershme për familjet me raste fatkeqësie”, në vlerën 100 000 ( njëqind mijë )lekë.
10. Për familjen e **Z. ARMANDO ELEZ LEKAJ , DRITAN ELEZ LEKAJ , ELEZ ZENEL LEKAJ DHE ZNJ. SHEUKIJE FAIK BARDHI** kompensimi i dëmëve materiale ndërtimore sipas preventivave si dhe në orendi e pajisje do të bëhet në zbatim të Ligjit 45/2019 “ Për Mbrojtjen Civile “ neni 41 , të VKM-së Nr.329 datë 16.05.2012 pika 3 dhe të VKM-së Nr. 414 datë 08.07.2021 “ Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të Buxhetit të Shtetit për Mbrojtjen Civile “ pika 3.1/a nga fondet e kushtëzuara që do të akordohen nga Buxheti i Shtetit për vitin 2022 për Bashkinë Shkodër sipas Relacionit bashkëngjitur në masen 50 % të vlerës ndërtimore në shumën 1 275 572 (njemiljon e dyqind e shtatedhjetë e pesemije e peseqind e shtatedhjetë e dy) lekë dhe ne 50% të vlerës së orendive në shumën 329 900( treqind e njezet e nentemije e nenteqind ) lekë.
11. Ngarkohet administrata e bashkisë Shkodër për likuidimin e ndihmës së menjëhershme në shumës prej 100 000 ( njëqind mijë )lekë nga Buxheti i Bashkisë .
12. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
13. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore.

**KRYETAR**

  
**Brisela KADIA**

Sekretari i Këshillit Bashkiak

  
**Denis Lesna**

Miratuar me 37 vota

Vota Pro 37

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 10.1.2022